

FORMULAR TIP II

DËGJESA ME PUBLIKUN PËR VENDODHJEN E INSTALIMIT

NJOFTIM

Agjencia Kombëtare e Mjedisit/ARM Shkodër e deleguar, njofton se do të organizohet **Dëgjesa publike/seanca dëgjimore** ku ftohen të jenë pjesëmarrës dhe palët e interesuara, në lidhje me vendodhjen e aktivitetit para se kërkuesi të aplikojë **për VNM e Thelluar**.

- **LLOJI I INSTALIMIT: Hidrocentrali GOJAN**
- **EMRIN E PERSONIT JURIDIK: “M.C. ENERGJI GOJAN” Sh.p.k.**
- **ADRESËN E VENDODHJES SË INSTALIMIT: Lumi Fan i Madh, zona midis fshatrave Shkozë dhe Gojan, Njesia Administrative Gjegjan, Bashkia Puke, Qarku Shkoder.**
- **ADRESA ELEKTRONIKE E AKM-së: info@akm.gov.al, ku publiku i interesuar dërgon komente dhe sugjerime, lidhur me zhvillimin e aktivitetit.**
- **VENDI I TAKIMIT: Fshati Kalivar, NjA. Gjegjan, Bashkia Puke**
[TEL:0682090472](tel:0682090472)
- **DATA DHE ORA E DËGJESËS: Data 26 Dhjetor, 2019 ora:11:00**
- **Mbaj përgjegjësi për dorëzimin e njoftimit pranë NJQV-së përkatëse në 20 kopje CD/DVD**

Ftohen të marrin pjesë në këtë takim:

- Përfaqësues nga AKM / ARM
- Përfaqësues nga NJQV
- Përfaqësues nga OJF, OJQ
- Përfaqësues nga shoqëria civile
- Përfaqësues të bizneseve përreth
- Përfaqësues nga media vizive dhe të shkruara lokale
- Banorë të zonës përreth

ZHVILLIMI I SEANCËS DËGJIMORE

Pjesëmarrësve në takim iu shpërndahet informacioni si më poshtë:

Vendi i zbatimit të projektit: Zona ku parashikohet të ndërtohet hidrocentrali Gojan ndodhet, në luginën e lumit Fan i Madh, në rrjedhjen e sipërme të tij, në zonën midis fshatrave Shkozë dhe Gojan, është i tipit me derivacion.
Aktiviteti: Prodhim i energjise elektrike nga burime te rinovueshme te energjise HIDROCENTRALI GOJAN
Kapaciteti, teknologjia: <ul style="list-style-type: none">- Fuqia e instaluar: 15000 kW- Energjia e prodhuar: 47,800,00 kWh
Lëndët e para, energjia, uji që do të përdoren: <ul style="list-style-type: none">- Uji i lumit Fan i Madh, në rrjedhjen e sipërme të tij, në zonën midis fshatrave Shkozë dhe Gojan
Kohëzgjatjen e punimeve dhe funksionimit: <ul style="list-style-type: none">- Kohezgjatja e punimeve 23 muaj
Mbetjet që do të gjenerohen, lloji dhe sasia e tyre: Ndertimi i HEC GOJAN është përlllogaritur përafërsisht të krijojë një volum dherash të gërmuar prej 169.000 m ³ , nga te cilat pjesa me e madhe do te perdoret perseri per mbulimin e tubacionit te presionit dhe risistemim prane nenobjekteve te tjera te vepres. Nje sasi e vogel do te depozitohen, kjo sasi do të sistemohet në sheshin qe do te vihet ne dispozicion per kete qellim ne bashkepunum dhe me bashkite ku kryhet ky aktivitet.
Ndikimet negative në shëndet e mjedis: HEC-et ndikojnë ndjeshëm në zhvillimin e një lumi. Ndër pasojat më të njohura, renditen ndikimi i drejtpërdrejtë në karakteristikat fiziko-kimike dhe biologjike të tij. Konkretisht, mund të përmendim: <ul style="list-style-type: none">- <i>trasformimin e rrjedhës së lumit në pjesën e sipërme të digës nga një sistem natyror lumor në system të një rezervuari artificial me ujëra të ndenjura,</i>- <i>bllokimin e qarkullimit të peshqve ose specieve të tjera ujore,</i>- <i>prishjen e ekuilibrave e proceseve fizike dhe habitateve në rrjedhën pas digës. Zakonisht, HEC-et dhe pritat e tilla, që nuk lejojnë kalimin e materialit zhavorror shkaktojnë prishjen e ekuilibrit të grykëderdhjeve duke shkaktuar erozionin detar, atë të ishujve, zonave pjellore të lumenjve dhe zonave të tjera kënetore,</i>- <i>ndryshimin e rrjedhës së lumit dhe të prurjeve të sedimentit zhavorror, të trashë, në rrjedhën e poshtme të lumit me pasoja të rënda për deltat, florën e faunën, për faktin se jeta në lumë dhe përreth sistemit të lumit kushtëzohet dhe zhvillohet në varësi të rrjedhës dhe sedimentit,</i>- <i>thelimin e shtratit të lumit, i cili ul edhe nivelin e ujit në akuifere.</i> Zhvillimi i aktivitetit do te sjell emetime te pluhurave ne mjedis gjate ndertimit te objektit, burime te tjera ndotese per ajrin nuk do te kete. Pajisjet qe do te perdoren per shfrytezimin dhe transportin e materialeve dhe te dheut do te jene bashkohore dhe ne gjendje te mire teknike ne menyre qe te shmangen emetimet nga djegia e lendeve djegese qe ato perdorin. Ne vende te caktuara ne projekt (shesh-depozitimi) parashikohet depozitimi i materialit te nga germimet dhe perpunimi i tij me toke vegjetale per te mundesuar mbjelljen e bimeve dhe pemeve karakteristike te zones gjate fazes se rehabilitimit. Dherat e depozituara ne damba

do te perpunohen me dhera te pasura me humuse, do te transportohen dhe shperndahen ne sheshin e shkalleve te skarpatave dhe shesh-depozitimit me trashesi mbi 20cm dhe do te pyllzohen me bime qe rriten ne zone per gjelberimin e saj.

Masat që do të merren për reduktimin e tyre:

Sipas pershkrimeve dhe percaktimeve ne Raportin e VNM-es

Projekti do të zhvillohet në harmoni me vlerat e natyrës. Kompania ndërtuese, do t'i kushtojë vëmendje: sitemimit të materialit të krijuar nga gërmimet, sitemimit të brigjeve dhe shpatit te kanalit, etj. Studimi gjeologjik, gjeomjedisor, gjeomorfologjik i shërbejnë masave të qëndrueshmërisë së objektit dhe terrenit. Nuk pritet të ketë: ndikim mjedisor të matshëm, sepse nuk ka prodhim të mbetjeve të rrezikshme; ndotje të tokës, ujit me shkarkime të ndryshme të lëngëta, apo të ngurta; shkarkime të gazrave apo të tymrave; zhurmat janë të papërfillshme dhe në fazën e ndërtimit; aroma shqetësuese; rritje temperature apo lagështie në mjediset e punës. Janë parashikuar masat sigurim teknike në punë.

- Menaxhimi i mbetjeve te gjeneruara nga punimet e gërmimit
- Menaxhimi i prurjeve ekologjike dhe atyre te nevojshme per vaditje

Masat që do të merren për monitorimin e tyre:

Sipas pershkrimeve dhe percaktimeve ne Raportin e VNM-es

- Integriteti i veprave hidrike, vepres se marrjes, kanalit vadites, urekanleve, urekalimeve
- Monitorimi i prurjes ekologjike dhe sezonit te vaditjes

Mbahen shënime si më poshtë:

- Minutat e takimit të shoqëruara me foto
- Emrat e pjesëmarrësve
- Problemet e ngritura nga të pranishmit, pyetje, komente, sugjerime dhe konkluzionet e arritura gjatë kësaj mbledhje
- I gjithë takimi zbardhet nga përfaqësuesi i shoqërisë dhe i bashkangjitet dosjes së aplikimit

Nr	Emër, mbiemër	Institucioni, Statusi	Nr. i kartës së identitetit	Largësia e banesës nga objekti (deklaruar nga banori)	Nënshkrimi
1	Alben Lisi	Etspert	033212080	—	
2	Dionisio Munko	Iny	I404020940		
3	Asteri HJSEHI	BASHKICIA POLICE	I406101291C	—	
4	Edvard Gjoko	Bonorë	I20714042H	300 m	
5	Pashk Lela	Banorë	G70327229C	320 m	
6	Errok Gjoka	Bonorë	F704030E	10 km	
7	Princ N. Gjoka	Bonorë	F4061604E	1014 m	
8	Vitor Gjini	Banor	I60523042E	201 m	
9	Gjovelin Kola	Banor	F20525146B	300 m	
10	Edmond Kola	Banor	I50216080R	300 m	
11	Alonk Kola	Banorë	D90412030G	500	
12	ZEF PALUCA	BANOR	I90601005J	1000	
13	Pashk. Peci	BANOR	G8041511P		
14	Mouchi Guli	HCENERGY GOJAN Investitor	G20108138M		
15					
16					
17	Erben Brojaj	D. R. M. SHIFODER	G70305111X		
18					
19					
20					
21					
22					
23					
24					
25					

(Foto nga takimi)



